



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 13.11.2023, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Ndreca – zëvendëskryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore për shqyrtimin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024”, me institucionet:

1. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
2. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
3. Instituti i Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit
4. Komisioneri i Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil
5. Autoriteti për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit

Marrin pjesë:

Eduard Ndreca, Saimir Hasalla, Bardhyl Kollçaku, Denis Deliu, Ermonela Felaj, Aurora Mara, Arkend Balla, Petro Koçi, Lavdrim Krrashi, Pandeli Majko, Fatmir Xhafaj, Gerta Duraku, Toni Gogu, Dhurata Çupi, Damian Gjikhuri, Jurgis Çyrbja, Xhemal Qefalia, Oerd Bylukbashi, Greta Bardeli, Dashnor Sula, Gledis Çeliku dhe Olta Xhaçka.

Mungojnë:

Klotilda Bushka, Klevis Xhoxhi, Fatmit Mediu, Bledion Nallbati, Saimir Korreshi, Elda Hoti, Gazmend Bardhi, Enkelejd Alibeaj dhe Erisa Xhixho.

Të ftuar:

Robert Gajda – komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Ana Muça – përfaqësuese e Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Erion Lili - specialist te Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Besnik Dervishi - komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Besa Velaj – drejtoreshë e kabinetit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Elona Hoxhaj – drejtoreshë e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit te Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Çelo Hoxha - drejtor Ekzekutiv në Institutin e Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit

Zoica Graçi - drejtoreshë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse në Institutin e Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit

Admira Imeraj - specialiste e Financës dhe e Buxhetit të Mbikëqyrjes në Institutin e Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit

Ollga Hodaj – drejtoreshë e Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse në Komisionerin e Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil

Enkelejda Hebibasi – drejtor i Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit në Komisionerin e Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil

Arbana Basha – drejtoreshë e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes në Komisionerin e Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil

Gentiana Sula – kryetare e Autoritetit për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

Albert Nikolla - anëtar në Autoritetin për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

Altin Hoxha – anëtar në Autoritetin për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

Gjergj Marku – anëtar në Autoritetin për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

Skënder Vrioni - anëtar në Autoritetin për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

Besa Spaho – përgjegjëse e Financave në Autoritetin për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

Vilma Çausholli – përgjegjëse Sektori në Drejtorinë e Analizës dhe Programimit Buxhetor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Eduard Ndreca – Mirëmëngjesi, të nderuar kolegë!

Hapim mbledhjen e sotme.

Së pari, verifikojmë prezencën e kolegëve, për të parë nëse plotësohet kuorumi: Saimir Hasalla, Bardhyl Kollçaku, Denis Deliu, Ermonela Felaj, Aurora Mara, Arkend Balla, Petro Koçi, Lavdrim Krrashi, Pandeli Majko, Fatmir Xhafaj, Gerta Duraku, Toni Gogu, Gledis Çeliku dhe Olta Xhaçka. Besoj se kuorumi është i plotë për të vazhduar mbledhjen.

Mbledhja e sotme vijon me dëgjuesat për shqyrtimin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024”. Sot kemi 5 seanca dëgjimore me institucionet e mëposhtme:

1. Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi
2. Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
3. Institutin e Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmi
4. Komisionerin e Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil
5. Autoritetin për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit

Pika e parë është seancë dëgjimore për shqyrtimin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024” me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Kolegu Saimir Hasalla do të jetë relatori për të gjitha këto dëgjesa. Pas të ftuarve në fillim do ta marrë fjalën zoti Hasalla dhe më pas zonja Vilma Çausholli nga Ministria e Financave.

Për këtë pikë të rendit të ditës kemi të ftuar zotin Robert Gajda, Komisioner, zonjën Ana Muça, përfaqësuese e Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, dhe zotin Erion Lili, specialist.

Fjala për ju, zoti Gajda, për të parashtruar gjithçka keni bërë në vitin 2023 dhe për projektbuxhetin e vitit 2024 për institucionin tuaj.

Robert Gajda – Faleminderit!

Ne jemi njohur me projektbuxhetin e vitit 2024, dhe na vjen mirë që janë reflektuar edhe aspektet e pagave me rritjet e reja.

Në lidhje me realizmin e buxhetit të vitit 2023, mendoj se realizmi është shumë i mirë në aspektin e përqindjeve, dhe ne synojmë realizmin mbi 90% të këtij buxheti. Kjo vjen për faktin

se volumi i punës i Komisionerit është rritur, normalisht edhe ezaurimi i buxhetit, i cili është i mjaftueshëm deri në momentin që flasim.

Në lidhje me buxhetin e vitit 2024, ne do t'ju riparashtrijmë disa kërkesa, që i kemi pasur edhe vitet e mëparshme, të cilat kanë gjetur miratim nga ky komision në mënyrë totale, por që nuk ka qenë e mundur të reflektohen ose të vazhdojë miratimi i tyre nga Komisioni i Ekonomisë. Gjithsesi, ne po jua riparashtrijmë si nevoja të institucionit, që i konsiderojmë vitale për arsye të një trendi rritës të volumit të punës së Komisionerit, si me rritjen e numrit të ankesave, gjë që reflektohet pastaj në të gjitha departamentet, sepse rritje e numrit të ankesave do të thotë rritje e numrit të vendimeve, për rrjedhojë edhe rritje e numrit të çështjeve në gjykatë, pasi mbi 80% e vendimeve të Komisionerit ankimohen në gjykatë, për rrjedhojë ka edhe rritje e volumit të punës në të gjitha departamentet.

Tani, pa ju marrë shumë kohë, ne jua kemi dërguar paraprakisht në mënyrë elektronike, por edhe me shkresë nevojat buxhetore të institucionit. Janë dy aspekte, për të cilat kërkojmë një rritje të buxhetit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, pika e parë lidhet me rritjen në staf të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe pika e dytë lidhet me mundësinë e parashikimit në buxhet për të marrë ekspertë në disa çështje, të cilat kërkojnë njohuri të veçantë, pasi me ndryshimet ligjore të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri mund edhe të thërrasë ekspertë, por, për aq kohë sa nuk është i rregulluar aspekti buxhetor i kësaj pjese të kompetencës, le të themi, na mbetet e pazbatuar dhe na pamundëson disa nga çështjet që kërkojnë një dijeni dhe natyrë të veçantë dijesh, pasi jemi të pamundur të mund të konkludojmë hetime në mënyrë fillestare.

Kërkesa e parë lidhet me mundësinë për të pasur dy specialistë të rinj në institucion, një për drejtorinë e Juridike, që mban peshën më të madhe për çështjet ligjore që lidhen me institucionin e Komisionerit, jo vetëm me përfaqësimet në gjykatë, por edhe me opinionet e dhëna në opinionet ligjore, që parashtrihen në Kuvend, që parashtrihen në pushtetin ekzekutiv, që parashtrihen në Gjykatën Kushtetuese, por edhe me të gjitha aspektet e tjera ligjore, që institucioni ynë kryen.

Nga ana tjetër, duke qenë se një aspekt shumë i rëndësishme i institucionit të Komisionerit është të monitorojë, në momente të ndryshme, situatën e diskriminimit, që mund të lidhet me shkaqe të ndryshme apo me fusha të ndryshme, dhe për të pasur mundësi për të kryer më shumë monitorime si institucion, duke pasur parasysh rritjen e volumit të përfshirjes së

Komisionerit në disa strategji të ndryshme, ku do të duhet të kryhen monitorimet, është i nevojshëm edhe shtimi i një specialisti në Drejtorinë e Monitorimit, në mënyrë që të mund të kryhen monitorime jo vetëm në aspektin sasior, por edhe në aspektin cilësor. Kjo vjen si pasojë edhe e rezolutave të Kuvendit, të cilat, në mënyrë të herëpashershme, nxisin Komisionerin që të kryejë monitorime të ndryshme në aspekte dhe fusha të ndryshme të jetës.

Në thelb kërkesa e institucionit, le të themi, kondensohet në këto tri pika: pra mundësia financiare e pasjes së një specialisti shtesë në Drejtorinë Juridike, një specialist shtesë në Drejtorinë e Monitorimit dhe mundësia financiare që të marrim ekspertë në ato çështje ku dijenia e institucionit është e mangët. Në thelb këto janë kërkesat e institucionit.

Eduard Ndreca - Faleminderit!

Fjala për kolegun Hasalla, si relator.

Saimir Hasalla - Faleminderit!

Në mënyrë të përmbledhur buxheti i vitit 2024 për Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi në total është parashikuar në masën 71,2 milionë lekë, nga të cilat 58 milionë lekë për zërin “Paga dhe sigurime shoqërore”, 11,9 milionë lekë shpenzime në zërin “Mallra dhe shërbime”, 200 mijë lekë në zërin “Shpenzime për transfertën” dhe 1 milionë lekë në zërin “Shpenzime për investime”. Numri i punonjësve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2024 është parashikuar të jetë 34.

Në krahasim me ndryshimet e fundit të bëra në buxhetin e vitit 2023, nëpërmjet aktit normativ nr. 5, rezulton se shpenzimet totale të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë rritur me rreth 15,3 milionë lekë ose 27,4% më shumë, nga të cilat shpenzimet për pagat janë rritur me 15,1 milionë lekë ose 35% më shumë, shpenzimet për mallrat dhe shërbime janë rritur me 100 mijë lekë, zëri i transfertës nuk ka ndryshuar; shpenzimet për investime nuk kanë ndryshuar dhe numri i punonjësve nuk ka ndryshuar.

Referuar të dhënave të Ministrisë së Financave rezulton se fondet e akorduara për vitin 2023, sipas aktit normativ nr. 5, për nëntëmujorin e parë të vitit janë realizuar në masën 81%, nga të cilat shpenzimet për paga në masën 86%, shpenzimet për mallra dhe shpenzime në masën 68% dhe shpenzimet për investime nuk janë realizuar.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka paraqitur kërkesë për ndryshime pozitive me shtesa mbi fondet e akorduara në projektbuxhetin e paraqitur nga Këshilli i Ministrave në vlerën 3,83 milionë lekë, nga të cilat shtesë në strukturë për dy punonjës të pozicionit

“Specialist”, një në Drejtorinë Juridike dhe tjetri në Drejtorinë e Monitorimit, Raportimit dhe Komunikimit; dhe 2,88 milionë lekë shtesë në fondin e pagave për financimin e shtesës së kërkuar për dy punonjës; 1 milion lekë shtesë në zërin “Mallra dhe shërbime” për pagesën e ekspertëve të jashtëm të specializuar në fusha të caktuara.

Këto janë kërkesat nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në lidhje me projektbuxhetin e vitit 2024.

Faleminderit!

Eduard Ndreca - Faleminderit!

Fjala për zonjën Vilma Çausholli nga Ministria e Financave.

Vilma Çausholli - Faleminderit!

Lidhur me buxhetin e Komisionerit, sikurse e tha edhe relatori, është një buxhet në rritje dhe në vlerësimin tonë edhe në vitin 2024 ky buxhet do të mbulojë veprimtarinë e plotë të institucionit.

Lidhur me kërkesat shtesë të paraqitura nga institucione, të cilat nuk janë të përfshira në këtë buxhet, ju njoftojmë se janë kërkesa minimaliste, të cilat me një prioritizim të fondeve aktuale, edhe mund të përballohen brenda institucionit.

Lidhur me numrin shtesë të stafit, sigurisht kjo është në vendimmarrjen e këtij komisioni për të vlerësuar këtë strukturë shtesë, por dua të sjell në vëmendje që rritja e pagave ishte një rritje e konsiderueshme, e cila vlerësohet se do t’i nxitë më tej punonjësit e institucionit për të punuar më shumë dhe për të mundur për të përballuar sfidat e reja që paraqet viti 2024 për këtë institucion.

Faleminderit!

Eduard Ndreca - Faleminderit!

Tani, për të gjitha kërkesat që ka institucioni, relatori së bashku me përfaqësuesin e Ministrisë së Financave le t’i diskutojnë dhe, pastaj kur të kalojmë nen për nen, të shohim mundësinë e transferimit të këtyre kërkesave te komisioni përgjegjës.

Kolegë a ka pyetje? Nuk ka.

Faleminderit, zoti Gajda!

Jeni i lirë së bashku me kolegët tuaj.

Eduard Ndreca – Ne do të vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës, seancë dëgjimore me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen zoti Besnik Dervishi, Komisioner, zonja Besa Velaj, drejtoresh e Kabinetit, dhe zonja Elona Hoxha, drejtoresh e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit.

Fjala për zotin Dervishi për të parashtruar gjithçka është realizuar në buxhetin e vitit 2023 dhe pritshmëritë për buxhetin e vitit 2024.

Zoti Dervishi, fjala për ju.

Besnik Dervishi – Faleminderit!

Siç besoj jeni njohur, zyra e Komisionerit është gjithmonë në realizim të objektivave dhe të shpenzimeve sa i përket buxhetit të shtetit. Për vitin 2023, ashtu siç dhe ju i keni në dispozicion, më duhet t'ju informoj se për sa u përket investimeve, ato janë realizuar në masën 100%, ndërsa të gjithë zërat e tjerë janë në proces dhe, ashtu si edhe vitet e kaluara, do të realizohen mbi 99%.

Sa i përket buxhetit të vitit 2024, mua më duhet t'ju përmend shumë shkurt, dhe ju falënderoj për kohën tuaj, një pasazh nga një dokument shumë i rëndësishëm i BE-së, që do t'ju vihet në dispozicion shumë shpejt, ku cilësohet se rekomandimi më i rëndësishëm do të ishte që institucionet publike duhet ta vendosin mbrojtjen e të dhënave personale si një çështje me prioritet të lartë, duke përcaktuar edhe hapat që duhet të merren jo vetëm nga zyra e Komisionerit, por nga të gjitha institucionet publike shqiptare për të plotësuar standardet e BE-së dhe parimet e sigurisë së të dhënave personale.

Gjithashtu, në përfundim të këtij raporti, cilësohet se për të demonstruar pavarësi të financiare, institucioni, pra zyra e Komisionerit, duhet të pajiset me burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare, duhet të ekzistojë edhe pavarësia për të përcaktuar si shpenzohet buxheti.

Sa u përket kërkesave të vitit 2024, ne i kemi paraqitur në kërkesat tona për buxhetin. Ju kemi dërguar edhe një relacion të përmbledhur, të cilin ju kemi vënë në dispozicion. Në lidhje me objektivat, që zyra e Komisionerit duhet të realizojë, e kombinuar kjo dhe me detyrat dhe standardet që ne duhet të plotësojmë, në kuadër të procesit të integritetit evropian, e lidhur, gjithashtu, me zhvillimet teknologjike, me masat e marra për zhvillimet teknologjike dhe ofrimin e shërbimeve publike, në një mënyrë të caktuar, ku janë hequr të gjitha sportelet dhe çdo shërbim publik ofrohet në mënyrë elektronike, natyrisht që duhen marrë edhe masat e sigurisë shumë të forta për sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale, sepse, në fund të fundit, 95% e këtyre shërbimeve publike nuk bëjnë gjë tjetër, veçse përpunojnë të dhënat personale të shtetasve

shqiptarë. Në këtë kuadër ne kemi kërkuar një rritje prej 20 mijë lekësh për sa i përket artikullit 602, që konsiston si në rritjen e aktiviteteve të zyrës së Komisionerit, por edhe në vlerën e 10 mijë lekëve për sa i përket një fushate shumë të gjerë ndërgjegjësuese, që i korrespondon miratimit të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale” që do të jetë 100% i transpozuar, do të jetë ligji i parë 100% i transpozuar me rregulloren e re të përgjithshme të BE-së.

Gjithashtu, është parashikuar edhe një kosto prej 5 mijë lekësh sa i përket mirëmbajtjes së databazeve shtetërore që ka zyra e Komisionerit, sepse nuk mund të riskojmë në sigurinë e tyre.

Gjithashtu, sa i përket artikullit 231 “Shpenzime për rritjen e aktiviteteve të detyrueshme të trupëzuara”, është parashikuar një shtesë në kërkesat tona prej 22 milionë lekësh, që ka të bëjë me aspektet teknologjike, që konsiston në pajisjet TIK për *domain controller* të zyrës së Komisionerit, si dhe mirëmbajtja në vlerën 13 milionë lekë. Gjithashtu, janë 4 milionë lekë pajisje dhe programe, të cilat, ju duhet të kuptoni, që zyra e Komisionerit, nëse duhet të ushtrojë funksionet e saj të mbrojtjes, të monitorimit dhe sigurisë së të dhënave personale, duhet të ketë disa pajisje dhe programe specifike, të cilat ndoshta është periudha që ne t’i përdorim.

Natyrisht, stafi është trajnuar, ne kemi siguruar trajnime nëpërmjet kontributit të BE-së, por janë pajisje, të cilat duhet të na vihen në dispozicion.

Gjithashtu, në lidhje me kërkesat shtesë përtej tavaneve, politikat e reja, siç ne ia kemi bërë me dije dhe komisionit tuaj, të nderuar, që vitin e kaluar, zyra e Komisionerit është përzgjedhur për organizimin e Konferencës Botërore të Komisionerëve të Informimit, që është event i më i rëndësishëm botëror në fushën e transparencës dhe të drejtës për informim, parashikohet të realizohet në muajin qershor. Natyrisht, është parashikuar rreth 30-35% e vlerës së kërkuar prej nesh në buxhet, por vlera e parashikuar do të ishte krejt e pamjaftueshme nëse kjo nuk do të bëhej e plotë, për aq sa ka kërkuar zyra e Komisionerit, dhe dokumenti disponohet nga Ministria e Financave.

Ky diskutim është bërë edhe vitin e kaluar, për hir të së vërtetës, dhe është lënë që, me ndryshimet që mund të bëheshin me akt normativ gjatë vitit 2023, një pjesë do të riallokohej për vitin 2023 dhe pjesa tjetër në buxhetin e vitit 2024. E vetmja gjë që ka ndodhur është një rialokim brenda fondeve të zyrës së Komisionerit, të cilën ne do ta plotësojmë dhe do të realizohet 100% dhe do të jetë një ndihmë dhe një mbështetje sa i përket kësaj konference, por duhet edhe vlera tjetër, sepse nuk mundet të riskojmë për mungesën e organizimit të saj.

Gjithashtu, është edhe një kërkesë që zyra e Komisionerit e paraqit jo për herë të parë, është paraqitur edhe vitin e kaluar. Tashmë kemi si objektiv digjitalizimin e programeve të transparencës, që është elementi më i rëndësishëm për sa i përket transparencës së autoriteteve publike; është ai me të cilin çdo autoritet publik prezanton punën dhe performancën e tij.

Pas 9 vjetësh të hyrjes në fuqi të ligjit “Për të drejtën e informimit”, në vitin 2024 bëhen 10 vjet, do të ishte në nderin dhe në lartësinë jo vetëm të zyrës së Komisionerit, por të të gjitha organeve publike shqiptare, që ne të arrijmë një standard të lartë sa i përket digjitalizimit të programeve të transparencës. Për fazën e parë ne kemi parashikuar një vlerë prej 3,5 milionë lekësh.

Gjithashtu, kërkesa e fundit, që është paraqitur nga ne, është diçka e njohur tashmë nga komisioni, ku i është lënë një detyrë zyrës së Komisionerit për të hartuar një projektligj për sa u përket thirrjeve të pakërkua, që ka të bëjë me krijimin e regjistrimit të thirrjeve të pakërkua, por, përderisa ligji nuk është miratuar ende, natyrisht kjo mbetet një kërkesë, që është në varësi të miratimit të ligjit.

Në total, për sa u përket kërkesave të zyrës së Komisionerit, keni tabelën përmbledhëse, që ju është vendosur në dispozicion. Unë do të kërkoja mbështetjen tuaj, sepse janë kërkesa që lidhen drejtpërdrejt me mirëfunksionimin e zyrës së Komisionerit. Siç jua përmenda, nuk ka nevojë të na e thonë të tjerët se sa rëndësi duhet t’i kushtojmë transparencës së autoriteteve publike, veçanërisht mbrojtjes së të dhënave personale, kjo lidhet edhe me disa ngjarje, të cilat, për hir të së vërtetës, pavarësisht mangësive në burime njerëzore dhe buxhetore, zyra e Komisionerit ka arritur t’i përballojë me sukses.

Mendoj se është momenti për të bërë një hop cilësor dhe zyra e Komisionerit i ka kapacitetet për t’iu përgjigjur niveleve dhe standardeve që kërkon BE-ja.

Gjatë kësaj jave kam ndjekur diskutimet e buxhetit nga shumë institucione publike, veçanërisht nga ministritë, që prezantojnë projektet e tyre, të cilat mbështeten nga ana financiare, dhe për këtë më vjen mirë që, kjo është një kënaqësi për të gjithë shtetasit shqiptarë! Ndoshta kërkesat që kanë institucionet e pavarura, ashtu siç tha edhe përfaqësuesja e Ministrisë së Financave, në raport me investimet e mëdha që po bëhen në vendin tonë, janë vërtet kërkesa minimaliste, për këtë do të doja që të merrnin vëmendjen e duhur, pavarësisht se janë minimaliste dhe të na vënë edhe ne në pozita të drejta për të realizuar objektivat tanë.

Mbetem në dispozicionin tuaj për çdo pyetje.

Ju faleminderit!

Eduard Ndreca – Faleminderit, zoti Dervishi!

Patjetër, kërkesat janë krejt të ligjshme dhe unë u sugjeroj edhe relatorit, edhe përfaqësuesve të Ministrisë së Financave, që këto kërkesa, kur ta trajtojmë buxhetin nen për nen, t'ia përcjellim më pas komisionit përgjegjës, sepse do të jetë ai që do të japë verdiktin final për të gjitha kërkesat e institucioneve.

Fjala për zotin Hasalla, si relator.

Saimir Hasalla – Faleminderit, zoti drejtues i komisionit!

Në lidhje me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, buxheti total i parashikuar për vitin 2024 për këtë institucion është rreth 114,7 milionë lekë, nga të cilat 117,5 milionë lekë janë për shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore; 25,9 milionë lekë janë për shpenzimet për mallra dhe shërbime, 300 mijë lekë janë te zëri “Transferta”; 1 milion lekë janë për shpenzimet për investime.

Numri i punonjësve të këtij institucioni për vitin 2024 është parashikuar të jetë 60. Në krahasim me ndryshimet e fundit, të bëra në buxhetin e vitit 2023, nëpërmjet aktit normativ nr. 5, rezulton se shpenzimet totale të këtij institucioni janë rritur me rreth 48,4 milionë lekë ose 50% më shumë, nga të cilat shpenzimet për paga janë rritur me 44,7 milionë lekë, ose 61% më shumë; shpenzimet për mallra dhe shërbime janë rritur me 8,7 milionë lekë ose 50,6% më shumë; dhe shpenzimet për investime kanë rënë me 5 milionë lekë ose 83% më pak. Numri i punonjësve është rritur me 8 punonjës, duke reflektuar ndryshimet e fundit, të miratuara në strukturë nga Kuvendi.

Referuar të dhënave të Ministrisë së Financave rezulton se fondet e akorduara për vitin 2023, sipas aktit normativ nr.5, për 9 muajt e parë të vitit janë realizuar në masën 77%, nga të cilat: shpenzimet për paga në masën 78%; shpenzimet për mallra dhe shërbime në masën 65%; dhe shpenzimet për investime në masën 100%.

Ky institucion ka paraqitur edhe kërkesat, që parashtrori drejtuesi, për shtesa buxhetore mbi tavanet e parashikuara në projektbuxhet, në një vlerë totale prej 79 milionë lekësh, nga të cilat 15,5 milionë lekë shtesë në zërin e shpenzimeve për përballimin e punonjësve shtesë me paga, miratuar me ndryshimet strukturore; 27 milionë lekë shtesë në zërin e shpenzimeve për mallra dhe shërbime, nga të cilat 20 milionë lekë do të jenë për mbulimin e aktiviteteve të shtuara, si pasojë e detyrave të reja ligjore, që i janë ngarkuar institucionit; 7 milionë lekë për

mbulimin e shpenzimeve dhe kostove administrative për organizimin e Konferencës Ndërkombëtare ICIC; 36,5 milionë lekë në zërin e shpenzimeve për investime, nga të cilat 13 milionë lekë për blerje pajisje TIK, për *domain controller* të IDP-së dhe mirëmbajtjen; 4 milionë lekë për blerje pajisjesh kompjuterike dhe elektronike; 5 milionë lekë për blerje automjeti; 11 milionë lekë për krijimin, zhvillimin, administrimin dhe monitorimin e regjistrimit të komunikimeve tregtare të pakërkuara; dhe, e fundit, 3,5 milionë lekë për platformën për digjitalizimin e programit të transparencës.

Këto ishin në mënyrë të përmbledhur kërkesat e këtij institucioni për projektbuxhetin e vitit 2024.

Faleminderit!

Eduard Ndreca – Faleminderit, zoti Hasalla!

Fjala për zonjën Çausholli, si përfaqësuese e Ministrisë së Financave.

Vilma Çausholli – Faleminderit!

Buxheti i vitit 2024 për Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale gjykojmë se reflekton punën e mirë të institucionit, që ndër të gjitha institucionet e paraqitura në këtë komision, është ndër institucionet që realizon më së miri treguesit buxhetorë të një viti më parë.

Mbështetur në reflektimin e këtij realizimi buxhetor, por mbështetur edhe në kërkesat e paraqitura nga institucioni, që gjithnjë janë të argumentuara dhe të arsyetuara, ne kemi parashikuar një rritje të ndjeshme të buxhetit të këtij institucioni, pavarësisht se sërish nga institucioni kërkohet një fond i ndjeshëm në buxhetin e vitit 2024, i cili përbën të paktën 56% të buxhetit të miratuar. Pra, janë kërkesa të larta, që vlerësojmë se duhet të rishikohen edhe gjatë veprimtarisë që do të realizojë ky institucion në vitin 2024. Me marrjen e stafit të ri, me marrjen e shpenzimeve operative gjykojmë se institucioni do të mund të mbulojë veprimtarinë kryesore të tij, pra është i mbështetur financiarisht.

Pastaj, lidhur me kërkesat për investime, unë do ta lija në vlerësim të komisionit, në diskutim edhe me specialistët e Ministrisë së Financave për projektet dhe programet e ndryshme kompjuterike, mund të rivlerësohen edhe një herë nga ana jonë.

Ju faleminderit!

Eduard Ndreca – Faleminderit, zonja Çausholli!

Ka pyetje dhe diskutime të tjera nga ju, kolegë të nderuar?

Besnik Dervishi - A mund të bëj vetëm një koment?

Me legjislacionin aktual, zyra e Komisionerit ka një mundësi ligjore për të siguruar donacione, të cilat ne i kemi aplikuar kryesisht me donacione ndërkombëtare. Me hyrjen në fuqi të legjislacionit të ri “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, kjo gjë është vendosur si kusht për t’u kufizuar nga ana e Komisionit European dhe do të krijojë një mangësi për sa i përket buxhetit të zyrës së Komisionerit. Më duhet t’ju përmend vetëm një shifër, vetëm vitin e fundit kemi pasur mundësi që të përdorim rreth 25 milionë lekë investime dhe shpenzime për të mbuluar aktivitetet kryesore të zyrës së Komisionerit, kryesisht me pajisjet e teknologjisë së informacionit, por edhe me aktivitetet ndërgjegjësuese që organizon zyra e Komisionerit. Pra, do t’ju lutesha të kishit në konsideratë edhe këtë aspekt. Ka qenë një burim që zyra e Komisionerit e ka përdorur me korrektesë gjatë gjithë këtyre viteve, por parashikohet që nga viti 2024 të mos e ketë më këtë mundësi për ta përdorur.

Në këto kushte, zyra e Komisionerit do të vendosej në një ngërç ose një situatë pak më të vështirë, ndaj do të kërkoja mbështetjen tuaj, të paktën për zërin e investimeve, për atë që u përket shpenzimeve operative për realizimin e konferencës, që, nuk ka nevojë ta përsëris, është një nga eventet më të rëndësishme dhe që e bën Shqipërinë dhe Tiranën kryeqendër të botës për sa i përket transparencës dhe të drejtës për informim për vitin 2024.

Jam i bindur që mbështetja juaj nuk do të mungojë, ashtu siç nuk ka munguar të gjitha vitet e tjera!

Ju falënderoj dhe ju uroj punë të mbarë!

Eduard Ndreca – Faleminderit, zoti Dervishi!

Zoti Hasalla dhe zonja Çausholli të kenë parasysh këtë kërkesë krejt normale të zotit Dervishi, për ta diskutuar më, pas kur të miratojmë projektbuxhetin nen për nen, për ta adresuar te komisioni përgjegjës.

Faleminderit, zoti Dervishaj!

Meqë s’ka pyetje dhe diskutime, jeni i lirë të shkoni.

Besnik Dervishi – Faleminderit ju!

Eduard Ndreca – Viojmë me pikën e tretë të rendit të ditës, dëgjuesë me Institutin e Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit për shqyrtimin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024”. Kanë konfirmuar pjesëmarrjen zoti Çelo Hoxha, drejtor Ekzekutiv i Institutit, zonja

Zoica Graçi, drejtore e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, dhe zonja Admira Imeraj, specialiste e Financës dhe e Buxhetit.

Fjala për zotin Hoxha, që të na parashtrojë të gjithë punën e bërë gjatë vitit 2023 dhe për të diskutuar për projektbuxhetin e vitit 2024.

Faleminderit!

Çelo Hoxha – Përshëndetje, zoti drejtues i komisionit!

Instituti për këtë vit në fushën e buxhetit ka punuar shumë mirë, i ka realizuar mbi 80% të parametrave të shpenzimeve për buxhetin, që deri në fund të vitit besoj se do të mbyllet pak a shumë me parametra shumë të mirë.

Më hollësisht për këto do të flasë drejtorja e Financës, por unë do të doja të thosha dy gjëra.

Së pari, në buxhetin e ri na janë premtuar nga Ministria e Financave 3 milionë lekë, të cilat nuk janë përfshirë në buxhet.

Së dyti, çështja e mjediseve ku punojmë, sepse kemi gati 1 vit e 2-3 muaj që punojmë në një godinë me qira, sepse do të restauroheshin mjediset. Afatet e kontratës kanë mbaruar, gjithashtu edhe restaurimet kanë mbaruar, kështu që jemi në pritje të një përgjigjeje nga Ministria e Kulturës për çështjen e kolaudimit të ndërtesës. Aktualisht vazhdojmë të jemi me zyra në ambientin me qira deri në muajin dhjetor dhe më pas, nuk e di, nëse do të vazhdojmë sërish edhe vitin e ardhshëm po me qira, duhet të futet si një shpenzim shtesë për qiranë. Nuk e di si do të zgjidhet kjo çështje, pastaj për detaje do të flasë drejtoresha e Financës.

Faleminderit!

Eduard Ndreca – Po, zonja Graçi, fjala për ju.

Zoica Graçi – Përshëndetje!

Buxheti për vitin 2023 është realizuar në masën 84% deri në datën 31 tetor të këtij viti, ndërkohë që për vitin 2024, ashtu siç edhe ju kemi bërë me dijeni, përmes relacioni të dërguar Kuvendit dhe Ministrisë së Financave, ne kërkojmë vetëm 3 milionë lekë shtesë të shpenzimet operative. Kjo gjë është kërkuar për 2 vjet radhazi nga ne. Ne e kemi realizuar projektin e marrëveshjes me Ministrinë e Arsimit, por me shtesën që na është dhënë, me anë të 3 punonjësve në sektorin e Edukimit, ne nuk mund ta vazhdojmë këtë projekt me Ministrinë e Arsimit pa shpenzimet operative, pra pa 2 milionë lekë shpenzime operative. Ne kemi 2 vjet që e kërkojmë

këtë gjë, pasi nga ju na është dhënë shtesa e punonjësve, është shtuar sektori, por kjo gjë ka ngelur thjesht vetëm me konkludimin e marrëveshjes me Ministrinë e Arsimit.

Një fond shtesë që kërkojmë është edhe 1 milion lekë të rinj për ristrukturimin e sajtit së ISKK-së, pasi ISKK-ja vetë ka botuar rreth 150 tituj librash, përveçse ka botuar edhe 12 vëllime të Fjalorit Enciklopedik të Viktimave, të cilat janë në formë digjitale dhe pritet të jenë të prekshme për publikun kombëtar dhe atë ndërkombëtar, megjithëse ne kemi kërkesa për këtë gjë, por me librat fizikë, me një tirazh prej 300 kopjesh, që ne bëjmë për çdo titull, nuk mund t'i arrijmë të gjithë.

Shpresoj që kjo kërkesë jona e sivjetshme për 1 milion lekë shtesë të merret parasysh nga ju dhe nga Ministria e Financave. Të gjitha këto kanë qenë të detajuar mirë në relacionin që i kemi dërguar në fund të muajit gusht Ministrisë së Financave dhe shpresojmë që kjo gjë të merret parasysh.

Faleminderit!

Eduard Ndreca – Faleminderit!

Zoti Hasalla, fjala për ju, si relator.

Saimir Hasalla – Faleminderit, nënkryetar!

Në lidhje me Institutin e Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, buxheti total i parashikuar për vitin 2024 është rreth 54,2 milionë lekë, nga të cilat 40,3 milionë lekë janë shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore; 12,7 milionë lekë shpenzime për mallra dhe shërbime; transfertat për buxhetet familjare 100 mijë lekë; dhe 1 milion lekë shpenzime për investime.

Numri i punonjësve të këtij institucioni për vitin 2024 është parashikuar të jetë 22. Në krahasim me ndryshimet e fundit, të bëra në buxhetin e vitit 2023, nëpërmjet aktit normativ nr. 5, rezulton se shpenzimet totale të këtij institucioni janë rritur me rreth 11, 1 milionë lekë, ose rreth 26% më shumë, nga të cilat shpenzimet për paga janë rritur me rreth 11,2 milionë lekë ose 38% më shumë; shpenzimet për mallra dhe shërbime kanë rënë me 300 mijë lekë ose 2,3% më pak; shpenzimet për investime nuk kanë ndryshuar.

Referuar të dhënave të Ministrisë së Financave, rezulton se fondet e akorduara për vitin 2023, sipas aktit normativ nr. 5, për 9 muajt e parë të vitit janë realizuar në masën 61%, nga të cilat shpenzimet për paga në masën 67%; shpenzimet për mallra dhe shërbime në masën 48,5%; dhe shpenzimet për investime janë realizuar 20%.

ISKK-ja ka paraqitur një kërkesë për ndryshimet buxhetore me shtesa për fondet e akorduara në projektbuxhetin e paraqitur nga Këshilli i Ministrave në vlerën 3 milionë lekë, për projekte strategjike të platformës së informimit për komunizmin në shkolla, një projekt i nisur që në vitin 2014, por tashmë me një program të qartë dhe të plotë veprimi, i cili konsiston në literaturë dhe paketë informuese, trajnime, ekspertizë historike dhe asistencë didaktike, e konkluduar kjo me marrëveshjen e nënshkruar me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

Këto ishin në mënyrë të përmbledhur kërkesat dhe realizimi i buxhetit nga ana e këtij institucioni.

Faleminderit!

Eduard Ndreca – Faleminderit, zoti Hasalla!

Fjala për zonjën Çausholli, që të na bëjë një shpjegim për të gjitha kërkesat që shtroi institucioni, edhe për çështjen e godinës, si dhe për probleme të tjera.

Vilma Çausholli – Faleminderit, zoti Ndreca!

Lidhur me Institutin e Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, gjykojmë se buxheti që i është dhënë, në masën 54,2 milionë lekë, është plotësisht i mjaftueshëm. Nëse institucioni do të punojë me këmbëngulje për realizimin e fondeve buxhetore të akorduara, gjykojmë se nuk do të ketë mangësi financimi në shpenzimet e tij. E themi këtë, sepse duke e parë në vite, por edhe duke u referuar në faktin e vitit 2022, ku realizimi 9-mujor është vetëm 50%, ne vlerësojmë se institucioni i ka pasur fondet në dispozicion për t'i kryer ato aktivitete të domosdoshme, të cilat i kërkojnë edhe për vitin 2023.

Mjafton të shohim vetëm shpenzimet e personelit, që, megjithëse kanë një strukturë të pandryshuar në numër punonjësish, nga 29 milionë që janë dhënë në fillim të vitit buxhetor, me gjithë rritjen e pagave, kanë mundur të realizohen vetëm 19,6 milionë lekë. Ndërkohë që për vitin 2024 parashikohen 40 milionë lekë, pra, nëse institucioni do të vijojë me të njëjtat ritme të shpenzimit, të përdorimit të këtyre fondeve buxhetore, vlerësojmë që gjatë vitit 2024 mund të kemi rialokime të mundshme, të cilat do të rezultojnë nga fondet e lira, pra të papërdorura dhe mund të alokohen për ato shpenzime shtesë prej 3 milionë lekësh që i kërkon sot institucioni

Gjithashtu, në lidhje me fondet e planifikuara për vitin 2024 për qiranë e institucionit, do të vlerësojmë se ky është një fond në dispozicion edhe për vitin 2024 dhe, nëse do të arrijë institucioni të futet në ambientet e reja, këto fonde do të lirohen. Pra, krijohet një burim i ri tjetër të ardhurash për vitin 2024, që janë mbi 1,1 milionë lekë, nga sa shikojmë, tek shpenzimet që ka

përdorur në vitin 2023 për qiranë e godinës. Kështu që ne vlerësojmë që me këtë buxhet, megjithëse minimalist dhe me kërkesa minimaliste, institucioni ka mundësi reale për t'i plotësuar të gjitha nevojat e tij edhe për strukturën e sapokrijuar, edhe për botime apo për realizimin e konferencave të ndryshme të institucionit. Ky është vlerësimi ynë.

Eduard Ndreca – Faleminderit, zonja Çausholli!

A ka ndonjë koleg pyetje, apo diskutime për të bërë?

Atëherë, e mbyllim edhe këtë pikë të rendit të ditës.

Faleminderit, zoti Hoxha, dhe të ftuarve të tjerë!

Jeni të lirë të vazhdoni.

Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës: seancë dëgjimore me Komisionerin e Mbikëqyrës së Shërbimit Civil. Kanë konfirmuar pjesëmarrjen zonja Arbana Basha, drejtoreshë e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes. Mirë se erdhët, zonja Basha!

Zonja Ollga Hodaj, drejtoreshë e Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse, dhe zonja Enkelejda Hebibasi, drejtoreshë e Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit. Mirë se erdhët!

Fjala për ju, zonja Basha, për të na i shpjeguar mënyrë të përmbledhur të gjithë realizimin e buxhetit për vitin 2023 dhe për projektbuxhetin e vitit 2024.

Faleminderit!

Fjala për ju.

Arbana Basha – Përshëndetje, të nderuar anëtarë të Komisionit të Ligjeve!

Ju falënderoj për mundësinë që i jepni Komisionerit për t'u dëgjuar në lidhje me projektbuxhetin e vitit 2024! Në bashkëpunim me ekspertët e Ministrisë së Financave, Komisioneri ka bërë një punë, në zbatim të ligjit dhe të akteve nënligjore që rregullojnë procesin e buxhetimit, duke hartuar projektbuxhetin e institucionit për vitin 2024.

Fondet buxhetore, të akorduara nga buxheti i shtetit për vitin 2023 për Komisionerin, janë administruar me efektivitet dhe me eficiencë, duke respektuar parimet dhe rregullat e menaxhimit financiar në përputhje me legjislacionin në fuqi, sipas një relacioni të hollësishëm që kemi dërguar pranë Komisionit të Ligjeve. Aktualisht, deri në fund të muajt tetor, është realizuar rreth 75% e buxhetit dhe vlerësohet se deri në fund të muajt dhjetor do të realizohet deri në masën 100%.

Në lidhje me tavanin e parashikuar në projektbuxhetin e vitit 2024, Komisioneri vlerëson se në shifrat akorduar institucionit janë vlerësuar dhe janë përfshirë të gjitha kërkesat e Komisionerit dhe ky buxhet i mbulon të gjitha nevojat për të kryer në normalitet funksionet e tij ligjore dhe nuk kemi asnjë kërkesë shtesë në lidhje me fondet buxhetore, pasi vlerësojmë se të gjitha kërkesat tona janë marrë parasysh nga Ministria e Financave.

Eduard Ndreca – Faleminderit, zonja Basha!

Fjala për zotin Hasalla, si relator.

Saimir Hasalla – Faleminderit!

Buxheti total, i parashikuar për vitin 2024 për këtë institucion, është rreth 97,5 milionë lekë, nga të cilat 78,3 milionë lekë shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore, 16,4 milionë lekë shpenzime për mallra dhe shërbime, 400 mijë lekë për zërin e transfertës dhe 2 milionë lekë për investime. Numri i punonjësve të këtij institucioni për vitin 2024 është parashikuar të jetë 37 punonjës. Në krahasim me ndryshimet e fundit të bëra në buxhetin e vitit 2023 nëpërmjet aktit normativ të nr. 5, rezulton se shpenzimet totale të këtij institucioni janë rritur me rreth 28,5 milionë lekë ose 41% më shumë; shpenzimet për paga janë rritur me 29,7 milionë lekë ose 61% më shumë; shpenzimet për mallra dhe shërbime kanë rënie me 100 mijë lekë dhe shpenzimet për investime kanë rënie me 1 milion lekë. Referuar të dhënave të Ministrisë së Financave, rezulton se fondet e akorduara për vitin 2023, sipas aktit normativ nr. 5, për 9 muajt e parë të vitit janë realizuar në masën 82%, nga të cilat shpenzimet për paga në masën 96%, shpenzimet për mallra dhe shërbime në masën 50% dhe shpenzimet për investime janë realizuar në masën 33%. Ky institucion nuk ka paraqitur asnjë kërkesë shtesë mbi fondet e akorduara në projektbuxhet.

Faleminderit!

Eduard Ndreca – Faleminderit, zoti Hasalla!

Zonja Çausholli, fjala për ju.

Vilma Çausholli – Faleminderit, zoti Ndreca!

Faktikisht, unë e mora fjalën vetëm për ta falënderuar institucionin, i cili gjithmonë ka kërkesa tepër modeste dhe e realizon gjithmonë buxhetin e parashikuar për atë vit. Për këtë arsye, për sa kohë edhe vetë institucioni nuk ka më kërkesa mbi ato të parashikuara në buxhet, unë shpreh falënderimet për këtë institucion modest që i realizon gjithmonë fondet e parashikuara.

Faleminderit!

Eduard Ndreca – Faleminderit, zonja Çausholli!

Shikoj se nuk kemi arsye as të pyesim dhe as të diskutojmë.

Megjithatë, kolegë, a keni pyetje apo diskutime për të bërë ? Nuk kanë.

Faleminderit, zonja Basha, bashkë me të gjithë kolegët!

Jeni të lirë të vazhdoni.

Punë të mbarë!

Vijojmë me pikën e fundit të rendit të ditës: seancë dëgjimore me Autoritetin për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Autoriteti: Gentiana Sula, kryetare e Autoritetit, Albert Nikolla, anëtar i Autoritetit; Altin Hoxha, anëtar i Autoritetit, Gjergj Marku, anëtar i Autoritetit.

Zonja Sula.

Nuk e kemi lidhjen. Mund të presim pak, sa të lidhemi me përfaqësuesit e Autoritetit.

Sofi Noti – Përshëndetje!

A dëgjohem?

Eduard Ndreca – Zonja Sula?

Sofi Noti – Nuk është zonja Sula në linjë. Unë quhem Sofi Noti dhe jam përfaqësuese e Autoritetit të Dosjeve. Jam drejtoreshë e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës dhe sekretare e Përgjithshme në detyrë. Do t'i prezantoj unë komentet e Autoritetit mbi projektbuxhetin e vitin 2024.

Eduard Ndreca – Faleminderit, zonja Noti!

Zonja Noti, kemi nevojë për një përshkrim të shkurtër për realizmin e buxhetit të vitit 2023 dhe për projektbuxhetin e vitit 2024 cilat janë pritshmëritë e institucionit tuaj.

Faleminderit!

Sofi Noti – Faleminderit!

Referuar buxhetit të vitit 2023, aktualisht jemi në situatën e realizmit të prokurimeve në zërat e skanimit të dokumenteve arkivore dhe të botimeve për materialet që Autoriteti prodhon vetë apo nëpërmjet bashkëpunimit me persona ose subjekte të treta dhe në procedurë prokurimi të një automjeti, që është i nevojshëm për nevojat e veprimtarisë së Autoritetit. Këto janë 3 procedura të konsiderueshme prokurimi, të cilat i kanë fondet të obliguara dhe, në qoftë se do t'i marrim në konsideratë, sepse janë në proces dhe nuk janë likuiduar, ne mendojmë se realizimi i

fondeve për vitin 2023 do të jetë në nivelin 65%-68%, pa llogaritur shpenzimet operative dhe shpenzime të tjera të parashikuara deri në fund të vitit. Normalisht, po të shikojmë akordimin e fondeve sipas projektvendimit të buxhetit për vitin 2024, vëmë re se për zërat e pagave dhe sigurimeve totali është në masën 94,4%, shpenzimet operative janë në masën 57% të totalit të kërkesave, që ka identifikuar institucioni, dhe shpenzimet kapitale janë në masën 15,2%. Ndërsa, krahasuar me buxhetin e vitit 2023, kemi 29% shpenzime operative më pak dhe 28,6% shpenzime kapitale më pak.

Për sa u përket shtesave të kërkuara, së pari, kemi identifikuar një diferencë të vogël për fondin e pagave dhe sigurimeve shoqërore. Sipas projektvendimit, fondi i akorduar për paga dhe sigurime shoqërore është 124 milionë lekë dhe, sipas kalkulimeve tona, për strukturën e plotë të Autoritetit, që është 73 persona, është llogaritur një diferencë prej 7 milionë e 324 mijë lekësh, që mungojnë në zërin e pagave dhe sigurimeve shoqërore, sipas projektligjit për buxhetin e vitit 2024. Ndërkohë që në pjesën e pagave dhe sigurimeve shoqërore nuk kemi përfshirë, por kemi bërë një kërkesë, kemi identifikuar një nevojë që në organikën e institucionit të futet, nëse do të shikohet e arsyeshme edhe nga Kuvendi, një këshilltar juridik për të qenë në funksion të kryetarit dhe të anëtarëve të Autoritetit, por edhe të administratës për çështje specifike që trajtohen gjatë mbledhjeve të Autoritetit, por edhe për nevojat draftuese të akteve nënligjore, marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe që Autoriteti nënshkruan me palët e treta. Ku e bazojmë këtë kërkesë?! Referuar eksperiencës së vitit 2023, ne kemi pajtuar për nevoja të kosnulencës juridike një ekspert të fushës për një periudhë 7-mujore. Duke parë që nevojat e Autoritetit janë të konsiderueshme dhe na është dashur ta përsëritim disa herë kontratën me ekspertin ligjor, kemi gjykuar që këtë ekspert ta bëjmë pjesë të strukturës së Autoritetit, nëse do të shikohet e arsyeshme edhe nga ju.

Për sa u përket shpenzimeve operative, në shpenzimet operative, sipas projektligjit “Për buxhetin vitit 2024” shifra e parashikuar është 26 milionë e 100 mijë lekë, ndërkohë që për vitin 2023 ka qenë 36 milionë e 651 mijë lekë. Ne kemi renditur disa nga nevojat, të cilat na çojnë në një konstatim që nevojat shtesë të institucionit në lidhje me shpenzimet operative janë 20 milionë lekë. Pra, përveç shumës 26 milionë e 100 mijë lekë, ne kërkojmë edhe një shtesë, nëse do të jetë e mundur dhe të shikohet e justifikuar, 20 milionë lekë.

Në shpenzimet operative kemi parasysh, në radhë të parë, strukturën e Autoritetit, e cila ka pësuar ndryshime. Kemi një drejtori të re të krijuar, Drejtorinë e Marrëdhënieve

Ndërinstitucionale në Procesin e Identifikimit dhe Rikuperimit të Personave të Zhdukur, e cila është një strukturë që është krijuar në mars të vitit 2022, por në 6-mujorin e dytë të vitit 2023, si rezultat i ndryshimeve ligjore, është përfshirë intensivisht në procesin e kërkimit dhe të identifikimit të personave të zhdukur. Si drejtori e re për vitin 2024 janë përcaktuar të kryhen disa aktivitete, të cilat janë renditur edhe në materialin që ne e kemi paraqitur si Autoritet, të tilla si: pjesëmarrja e stafit të drejtorisë në trajnime brenda dhe jashtë vendit për rritjen e kapacitetit të ekspertizës në lidhje me procesin e identifikimit dhe rikuperimit të personave të zhdukur në tematika si teknologjia e përdorur në proces, çështje të mjekësisë ligjore dhe antropologjisë apo fusha të tjera. Në kuadër të evidentimit të lokacioneve të vendvarrimeve eventuale të personave të zhdukur për vitin 2024 parashikohen lëvizje intensive në terren të stafit, ecuri që parashikon: kosto transporti, dieta për punonjësit dhe veprime për shënjimin e lokacioneve të ndryshme të dyshuara. Gjithashtu, planifikohet edhe kontraktimi i subjekteve me ekspertizë në fushë për ndërmarrjen pilotuese të disa kërkimeve në terren të vendvarrimeve të mundshme të personave të zhdukur. E nevojshme për vitin 2024 është asistencë teknike dhe logjistike në përpjekjet e para për kryerjen e procesit të identifikimit të personave të zhdukur, ekspertimi antropometrik i eshtrave, transporti i eshtrave drejt vendit të ruajtjes apo procese të tjera të nevojshme. Duke qenë se kjo drejtori është strukturë e re, mendojmë se nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet e nevojshme për realizimin e objektivave të parashikuar për vitin 2024. Kjo është një nga arsyet pse ne kërkojmë shtesë në zërin e shpenzimeve operative.

Një tjetër zë i rëndësishëm, në kuadër të funksioneve që ka Autoriteti i Dosjeve, është edhe organizimi i aktiviteteve me karakter informues, edukues ndërgjegjësues, organizimi i aktiviteteve për data përkujtimore, organizimi i konferencave shkencore apo edhe mbështetja e aktiviteteve kërkimore apo hulumtuese shkencore.

Po t'i referohemi buxhetit të vitit 2023, fondi për zhvillimin e këtyre aktiviteteve ka qenë i parashikuar në masën 1 milion e 200 mijë lekë, një fond, i cili mbulonte vetëm 30% të nevojave që ka identifikuar Autoriteti për zhvillimin e këtyre veprimtarive. Po t'i referohemi planifikimit për vitin 2024, është përmendur në dokument se janë planifikuar 8 aktivitete në total, 1 konferencë, 4 aktivitete përkujtimore, 2 *workshop*-e dhe një dialog lokal, për të cilat kërkohet mbulimi i zërave, si më poshtë: dizajni i materialeve audiovizuale, prodhimi i materialeve audiovizuale, qira salle, foni, drekë, ujë kafe, biskota, përkthim i materialeve të aktiviteteve me shkrim, realizim dokumentari ose kronike mbi temën e aktivitetit. Pra, siç thashë, gjatë vitit 2023

fondet kanë qenë të pamjaftueshme për të realizuar të gjithë gamën e aktiviteteve të parashikuara në këtë komponent të veprimtarisë së Autoritetit.

Për vitin 2024 kemi propozuar që nëpërmjet një marrëveshjeje kuadër ne të bëjmë prokurimin për një periudhë 2-vjeçare, 2024- 2025, me një fond prej 5 milionë lekësh, në funksion të zhvillimit të aktiviteteve të kësaj natyre. Pra, ne kërkojmë një fond me vlerë 2 milionë e 500 mijë lekë për vitin 2024, ndërsa 2 milionë e 500 mijë lekë të tjerë i kërkojmë për buxhetin e vitit 2025.

Për sa u përket publikimeve, Autoriteti realizon publikime duke u mbështetur në bashkëpunimin që ka me institucionet akademike nëpërmjet nxitjes së studiuesve, mësuesve, pedagogëve, studentëve, shoqërisë civile dhe përfaqësuesve të medias, me qëllim promovimin e aktiviteteve shkencore, konferencave, dokumentarëve dhe botimeve të ndryshme. Në vitin 2023 kemi prokuruar, nëpërmjet një marrëveshjeje kuadër në vlerën 5 milionë lekë, për realizimin e dizajnit dhe printimit të disa botimeve të Autoritetit, të cilat janë shumë të rëndësishme për bibliotekën e Autoritetit, por edhe për t'u përdorur në aktivitete të ndryshme me karakter informues apo ndërgjegjësues, kryesisht për shkollat.

Në vitin 2023 fondi i prokuruar është në vlerën 3 milionë lekë, ndërsa për vitin 2024 kërkojmë 3 milionë lekë shtesë për të realizuar zërin “dizain dhe botime” për botimet e Autoritetit.

Një zë tjetër i rëndësishëm është shpenzimi për skanimin e dokumenteve arkivore. Në punën tonë skanimi i dokumenteve arkivore është një element shumë i rëndësishëm, sepse evitojmë përdorimin e dokumenteve autentike të arkivit, që ne administrojmë, natyrisht i shërben edhe projektit të arkivit digjital, i cili është projekt në proces. Pra, aktualisht ne kemi zhvilluar një softuerë të arkivit digjital, që po popullohet me dokumente arkivore të skanuara, i cili do të jetë i aksesueshëm jo vetëm nga stafi i Autoritetit, por edhe nga subjekte që interesohen për arsye informuese apo studimore.

Në vitin 2023 ne kemi një fond prej 9 milionë lekësh...

Eduard Ndreca – Zonja Noti, ju lutem, përmbledheni, sepse kemi nevojë të dimë më shumë për kërkesat tuaja për vitin 2024.

Sofi Noti – Po, do të mundohem ta përmbledh sa më shumë.

Identifikimi i nevojave për skanim ka qenë për 3 milionë fletë për vitet 2023 – 2024. Në vitin 2023, sipas marrëveshjes kuadër, brenda këtij viti do të skanohen 1 milion e 413 mijë fletë

në vlerën 9 milionë lekë. Vlerën e mbetur prej 20 milionë lekësh, që ka qenë planifikuar për 3 milionë fletë e kërkojmë si nevojë për vitin 2024.

Për sa u përket shpenzimeve për shërbime e mirëmbajtje dhe shpenzime të tjera operative janë llogaritur me një koeficient rritës, për arsye se në vitin 2023 kemi pasur shtesë stafi, pra organika e Autoritetit nga 65 persona është rritur me 73 persona. Ne kemi marrë në konsideratë rritjen e të gjitha shpenzimeve operative, duke filluar nga kancelaria, pajisje, udhëtime, dieta, pajisje për pastrim dhe të gjithë zërat e tjerë të shpenzimeve brenda këtij zëri.

Për sa i përket zërit të investimeve, që është edhe zëri i fundit, parashikimi sipas projektvendimit për buxhetin e vitit 2024, është në vlerën e 2 milionë lekëve. Ky zë për Autoritetin nuk është i mjaftueshëm, ndaj kemi renditur edhe nevojat që kemi për këtë zë të buxhetit. Pra, kemi vendosur blerje orendish dhe pajisje për sektorin e kartotekës, që është një sektor i ri brenda drejtorisë së arkivit dhe ka nevojë për krijimin e mjedisit të përshtatshëm të punës, sepse do ta administrohen të gjitha kartelat, regjistrat apo evidencat e ndryshme të ish-Sigurimit të Shtetit të mbledhura sipas procedurave të parashikuara me ligj. Në dokument është paraqitur në mënyrë të detajuar se nevojiten rreth 50 - 60 rafte metalike, specifike për sektorin e kartotekës, dhe 3 tavolina pune me përmasa 3 me 2.

Kemi kërkuar blerjen dhe instalimin e impiantit hidrik për mbrojtjen kundër zjarrit, i cili i mundëson institucionit pajisjen me certifikatën e mbrojtjes nga zjarri, me qëllim garantimin e sigurisë së punonjësve, por edhe të materialeve që Autoriteti administron. Për këtë arsye nevojitet një fond prej 2 milionë lekësh për vitin 2024 që kërkohet për blerjen e pajisjes së impiantit kundër zjarrit.

Kemi një fond modest për përshtatjen e mjediseve për zyra, sepse godina aktuale nuk e mundëson akomodimin e 73 personave me poste pune. Ndaj duhen bërë disa ndërhyrje të vogla brenda godinës për të maksimizuar hapësirat aktuale të godinës ku zhvillon veprimtarinë Autoriteti.

Kemi zërin për instalimin e sistemit të sallës së mbledhjeve dhe sallës së studimit. Këtu kemi parasysh sallën e studimit, për të cilën është e nevojshme të pajiset me një sistem studimi dhe aksesim të materialeve nëpërmjet pajisjeve desktop të lidhura me njësi informacioni, sipas kërkesave pas përpunimit, anonimizimit dhe të gjithë veprimtarisë së punës që realizon Drejtoria e Mbështetjes Shkencore dhe Edukimit Qytetar.

E fundit, është realizimi i mbledhjeve të Autoritetit nëpërmjet një sistemi që eviton përgatitjen e materialeve fizikisht në letër dhe përdorimin e një sistemi informatik, ku të gjitha materialet kalojnë elektronikisht. Kjo do të ndikonte në ekonomizimin e shpenzimeve procedurale, të cilat do të kishte ndikim edhe në mjedis duke fotokopjuar më pak materiale dhe duke e bërë realizimin e mbledhjeve më efikas.

Në total fondet shtesë të kërkuara për zërin “shpenzime kapitale” janë në vlerën 13 147 500 lekë.

Këto ishin, pak a shumë, kërkesat e institucionit tonë.

Faleminderit!

Eduard Ndreca – Faleminderit, zonja Noti!

Në lidhje kemi edhe zonjën Sula. Kishim në lidhje zotin Skënder Vrioni dhe zonjën Besa Spaho, të cilët nuk i përmenda në fillim. Faleminderit që ishit me ne!

Zonja Sula, a keni diçka për të shtuar?

(Ndërprerje e incizimit.)

Faleminderit, zonja Sula!

E vlerësoj punën e institucionit dhe u kërkoj relatorit dhe përfaqësuesit të Ministrisë së Financave që t’i marrin parasysh kërkesat, me aq mundësi sa kemi, që të bëhen pjesë e buxhetit të vitit 2024.

Fjalën po ia kaloj relatorit, zoti Hasalla.

Faleminderit!

Saimir Hasalla – Faleminderit!

Në total projektbuxheti i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për vitin 2024 është rreth 152,1 milionë lekë, nga të cilat 124 milionë lekë janë shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore; 26,1 milionë lekë janë shpenzime për mallra dhe shërbime dhe 2 milionë lekë janë shpenzime për investime.

Numri i punonjësve të këtij institucioni për vitin 2024 është parashikuar të jetë 73 punonjës. Në krahasim me ndryshimet e fundit të bëra në buxhetin e vitit 2023 nëpërmjet aktit normativ nr. 5, rezulton se shpenzimet totale të këtij institucioni kanë një rritje prej rreth 19,4 milionë lekësh ose rreth 15% më shumë.

Shpenzimet për paga janë rritur me 35 milionë lekë ose 39,3% më shumë. Shpenzimet për mallra e shërbime kanë rënie me 10,6 mijë lekë ose 29% më pak dhe shpenzimet për investime kanë rënie me 5 milionë lekë ose 71% më pak.

Referuar të dhënave të Ministrisë së Financave, rezulton se fondet e akorduara për vitin 2023, sipas aktit normativ nr. 5, për 9 muajt e parë të vitit janë realizuar në masën 63%, nga të cilat shpenzimet për paga janë në masën 72%, shpenzimet për mallra e shërbime në masën 29% dhe shpenzimet për investime janë realizuar në masën 133% falë një investimi të huaj që ka marrë institucioni në vlerën 5,2 milionë lekë.

Ky institucion ka kërkuar për vitin 2024 një shtesë mbi tavanet buxhetore të parashikuara në projektligj në vlerën totale 41,1 milionë lekë, nga të cilat 7,3 milionë lekë shtesë në zërin e shpenzimeve për paga për përballimin e kostove shtesë nga zbatimi i VKM-së nr. 325 dhe kërkesa për shtesën e 1 punonjësi në pozicionin e këshilltarit për çështjet juridike në dispozicion të kryetarit të Autoritetit. 20 milionë lekë shtesë janë për zërin e shpenzimeve për mallra e shërbime për përballimin e aktivitetit të plotë të këtij institucioni dhe 13,8 milionë lekë shtesë janë për zërin e shpenzimeve për investime, që nevojiten për blerjen e raftëve për kartotetkën, blerjen dhe instalimin e impiantit hidrik të mbrojtjes kundër zjarrit dhe përshtatjen e mjediseve për zyra, instalime sistemi, sallë mbledhje dhe sallë studimi.

Këto ishin kërkesat e këtij institucioni në mënyrë të përmbledhur.

Faleminderit!

Eduard Ndreca – Faleminderit, zoti Hasalla!

Fjalën e ka zonja Çausholli.

Vilma Çausholli – Në lidhje me parashikimin buxhetor të vitit 2024 për Autoritetin e Dosjeve, dëgjova me vëmendje kërkesat e paraqitura nga institucioni dhe do të kërkoj që ky institucion t'i rivlerësojë edhe një herë këto kërkesa shtesë. Duke iu referuar shifrave që janë akorduar në fillim të vitit, shifrave që janë përdorur gjatë vitit buxhetor dhe shifrave që janë akorduar për vitin 2024, kanë një diferencë të madhe. Në këtë komision vitin e kaluar këtij institucioni iu dha një fond shtesë prej 20 milionë lekësh shpenzime operative për vijimin e procesit që kishte ndërmarrë ky institucion për identifikimin, rikuperimin e personave të zhdukur, për arkivin digjital, për botimet dhe për aktivitetet e tjera përkujtimore. Ky fond që iu akordua institucionit, është parashikuar në buxhetin e vitit 2023 dhe në total shifra shkoi 36,7 milionë lekë, nga të cilat brenda këtij 9-mujori kemi një realizim prej 10,5 milionë lekësh. Pra,

shumë nga ato kërkesa që u prezantuan si kërkesa shtesë në shpenzimet operative për të njëjtat procese, vlerësojmë se mund të realizohen me fondet e vitit 2023. Ndaj kërkojmë që të rishikohet kërkesa për fondet shtesë në vitin 2024.

Gjithashtu, dua të theksoj se edhe shpenzimet për personel nga përllogaritjet e kryera nga ana jonë janë plotësisht të mjaftueshme me strukturën e plotë me 73 punonjës.

Ndërkohë, nëse do të shikojmë realizimin e 9-mujorit të vitit 2023, janë realizuara pothuajse gjysma e fondeve të parashikuara në vitin 2024. Mbi këtë bazë institucioni, duke pasur parasysh se ka ende 2-3 muaj për realizimin e buxhetit të vitit 2023, ku ka një tepriçë të konsiderueshme të fondeve, t'i rishikojë edhe një herë kërkesat shtesë për vitin 2024.

Faleminderit!

Eduard Ndreca – Faleminderit, zonja Çausholli!

Përfaqësuesi i ministrisë bashkë me relatorin t'i marrin të gjitha kërkesat që paraqiti institucioni dhe t'i diskutojmë në momentin kur të shqyrtojmë projektbuxhetin nen për nen, pastaj t'ia adresojmë komisionit përgjegjës.

A ka pyetje apo diskutime nga kolegët?

Po, zonja Sula.

Gentiana Sula – I falënderoj relatorin dhe përfaqësuesen e Ministrisë së Financave!

Dua të bëj disa sqarime.

E para, vërtet duket sikur fondet e vitit 2023 janë të përealizuara, por, në fakt, ne kemi bërë kontratat, të cilat janë madhore. Për shembull, për skanimin e dokumenteve po punohet me dy turne dhe parashikojmë që t'i realizojmë shpenzimet për këtë vit.

Një arsye e vonesave që ka pasur institucioni në raport me realizimin, ka qenë mandati i kryetares, i cili është konstituuar nga Kuvendi në fund të dhjetorit. Pra, në janar ka filluar mandati i dytë i kryetares së Autoritetit, ndaj ne kemi bërë planin strategjik dhe e kemi miratuar në prill, se nuk e fillonim dot planin e vitit. Së pari.

Së dyti, ndryshimet strukturore u miratuan vjet në vjeshtë, kur ne filluam rekrutimet për disa shtesa, ndaj edhe me stafin kemi pasur mungesa, por tani jemi rregulluar.

Mendoj se fondi do të realizohet, sepse kemi bërë kontratën e skanimit dhe kontratën kuadër për publikimet, dhe jemi në rrugë të mbarë.

Për sa u përket të zhdukurve, ne kemi qenë në pritje të një VKM-je, që shpresojmë të jetë gati për t'u bërë. Unë mendoj se viti tjetër ka vërtet sfida të forta, ndaj do të isha shumë

falënderuese dhe mirënjohëse, në emër të institucionit, nëse do t'i merrni parasysh kërkesat tona buxhetore.

Kartoteka është e domosdoshme. Është bërë miratimi i strukturës, është bërë rekrutimi i sektorit të kartotekës, tani na duhen raftet e posaçme.

Për sa i përket sigurisë me pompën, ne e kemi rregulluar arkivin, që është financuar me donatorë të huaj, por bëhet fjalë për zyrat në dy katet e sipërme, të cilat janë parësore, sepse nuk marrim dot licencën e sigurisë. Pra, janë disa gjëra që i kemi bërë dhe i kemi planifikuar me shumë kujdes, ndaj mendoj se kanë bazë.

Gjithsesi, e falënderojmë për sugjerimin përfaqësuesen e Ministrisë së Financave! Ne do të ulemi edhe një herë që t'i shikojmë gjërat, por mendoj se ka vend që të mbështeten kërkesat tona.

Faleminderit!

Eduard Ndreca – Faleminderit, zonja Sula!

Ne do të bëjmë çdo gjë që është e mundur që të kontribuojmë për funksionimin siç duhet të këtij institucioni për vitin 2024 dhe për plotësimin e të gjitha nevojave që ju keni si institucion.

A ka ndonjë pyetje apo diskutim nga kolegët? Nuk ka.

Atëherë, faleminderit, zonja Sula, dhe të gjithë të ftuarve nga institucioni juaj! Jeni të lirë të shkoni. Punë të mbarë!

Duke falënderuar relatorin, zotën Hasalla, dhe zonjën Çauholli, përfaqësuese e Ministrisë së Financave, dhe ju, kolegë, që ishit prezent, e mbyllim mbledhjen për sot. Ne i kemi ezauruar 5 pikat që kishim si rend dite.

Për mbledhjen e ardhshme do të njoftoheni.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA